



IEKA Instituti i Eksperteve
Kontabel të Autorizuar

Eleda Dhima Auditues Ligjor
Licenca profesionale Nr.197, datë 30.01.2009

**RAPORT I AUDITIMIT TE FUSHATES
ZGJEDHORE 2019
PARTIA EMIGRACIONI SHQIPTAR**

Pala Angazhuese: KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Pala Përgjegjëse: PARTIA EMIGRACIONI SHQIPTAR

I. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

A. INFORMACIONI LIGJOR

Kuadri ligjor

Kriteret e auditimit, kundrejt të cilëve do të vlerësohet dhe matet shkalla e përputhshmërisë së fushatës zgjedhore me aktet ligjore dhe rregullative burojnë nga:

- Kodin Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë,
- Ligjin nr. 8580, date 17.02.2000, "Per partite politike" i ndryshuar me ligjin nr.90/2017,
- Udhëzimin e KQZ-së, Nr. 1, date 31.05.2017, "Për përdorimin e materialeve propagandistike dhe vendet për afishimin e tyre gjatë fushates zgjedhore",
- Udhëzimin e KQZ-së, Nr.2 date 01.06.2017 "Për miratimin e procedurave dhe kriterëve për përzgjedhjen dhe emërimin e ekspertëve financiar"
- Udhëzimin e KQZ-së, Nr.3 date 2.06.2017 "Për përlogaritjen e kostos financiare të veprimtarive, shërbimeve apo materialeve që do të perdoren për qëllime zgjedhore ose politike, nga partitë politike gjatë fushatës zgjedhore".
- Ligjin për kontabilitetin dhe standardet kontabël përkatëse,etj.

Standardet e kontabilitetit të zbatueshme

Në përputhje me ligjin, Nr.25/2018, datë 10.05.2018, "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", partitë politike kanë statusin e njësjefitoprurëse dhe janë objekt i Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit (SKK-të) dhe specifikisht i Standardit Kombëtar të Kontabilitetit të Organizatave Jo Fitimprurëse(SKK për OJF-të).

B. OBJEKTI I AUDITIMIT

Kontrata e shërbimit

Për përmbushjen e misionit të auditimit, në cilësinë e Ekspertëve Financiar, jam angazhuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në misionin e monitorimit të shpenzimeve të fushates zgjedhore 2019 të Partisë Emigracioni Shqiptar. nga partitë politike në përputhje me ligjin nr. 8580, datë 17.02.2000 "Për partitë politike", i ndryshuar, aktet nënligjore të KQZ-së të miratuara për këtë qëllim, ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratur", i ndryshuar, dhe ligjin nr. 25/2018, datë 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", se dhe aktet nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatim të tyre".

Vendimi i KQZ-së

Në përputhje me kuadrin rregullator të përzgjedhjes dhe emërimit të ekspertëve kontabël të licencuar për auditimin e partive politike, KQZ-ja në bazë të vendimit të KQZ nr 740 date 30.05.2019 "Për shpalljen e rezultatit të shortit për emërimin e ekspertëve financiarë dhe audituesve ligjorë të cilët do të kryejnë monitorimin dhe auditimin e fondeve të përfituara dhe

shpenzimeve të fushatës zgjedhore nga subjektet zgjedhore për organet e qeverisjes vendore të vitit 2019”Përgjegjësitë përkatëse të subjektit zgjedhor dhe audituesit ligjor

Qellimi i auditimit është analiza e informacionit mbi të ardhurat dhe shpenzimet në procesin e kryerjes së fushates që zhvillon Partia Emigracioni Shqiptar në gjithë teritorin e vendit, dhe analiza e tij për të vlerësuar shkallen e pajtueshmërisë së realizimit të fushatës zgjedhore të subjektit me kërkesat e akteve ligjore e nenligjore zgjedhore, kryesisht në aspektin financiar.

Pra, përveç gjetjes dhe raportimit të fakteve qellimi i auditimit është dhe vlerësimi i tyre nëse janë në pajtueshmeri me kërkesat të legjislacionit zgjedhor.

Në mënyrë të sintetizuar objektivat e auditimit jënë dhënë në Udhëzimin e KQZ-së, Nr.2, datë 01.06.2017 “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve për përzgjedhjen dhe emërimin e ekspertëve financiar“, nenin 3, sipas të cilit ekspertët financiar të emëruar sipas këtij udhëzimi duhet të monitorojnë në mënyrë specifike:

- a) Zbatimin e dispozitave ndaluese për financimin e fushatave të përcaktuara në Kodin Zgjedhor dhe në ligjin nr. 8580, datë 17.02.2000, “Për partitë Politike” i ndryshuar me ligjin nr. 90/2017;
- b) Dokumentimin e shpenzimeve të subjekteve të treta në funksion të veprimtarive të fushatës së subjektit zgjedhor;
- c) Respektimin e kufirit maksimal të shpenzimeve dhe të kufizimeve sipas llojit, sidomos përsa i përket materialeve propagandistike dhe reklamave televizive;
- d) Kostimin e veprimtarive të monitoruara me qëllim krahasimin e mëvonshëm me shpenzimet e deklaruara nga subjekti zgjedhor gjatë raportimit;
- e) Rregullat e brendëshme të subjektit elektoral për raportimin e shpenzimeve;
- f) Transaksionet financiare të kryera për periudhën 3 muaj përpara dhe pas ditës së zgjedhjeve, nga persona fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, me qëllim evidentimin e transaksioneve të pajustificuara dhe që mund të jenë përdorur për financim të paligjshëm të fushatës zgjedhore të një ose disa partive politike.

Në tërësi auditimi përfshin vëzhgimin e mbledhjen informacioneve financiare dhe jo-financiare që lidhen me zbatimin e dispozitave ndaluese dhe kufizuese nga subjekti zgjedhor gjatë zhvillimit të fushates por dhe ato financiare të shprehura specifikisht në udhëzimin e sipercituar.

Ky angazhim është një marrëveshje tri palëshe që përfshin ekspertët financiar palën përgjegjëse (Partinë Emigracioni Shqiptar) dhe palën angazhuese (KQZ-në) dhe ka elementet e duhur të një angazhimi për dhenie sigurie.

Përgjegjësia e palës përgjegjëse është që të zhvillojë fushatën zgjedhore në përputhje me legjislacionin zgjedhor, legjislacionin tatimor, ligjin për pasqyrat financiare dhe standardet kontabël etj

Përgjegjësia e ekspertëve është kryerja e auditimit në përputhje me standardet profesionale të cilat kërkojnë që në të respektuara të kërkesat etike, të planifikojmë dhe kryejmë angazhimin me

qellim që të arrije të marrë siguri të arsyeshme ose siguri të kufizuar në varësi të çështjes konkrete.

Si rrjedhojë e kufizimeve të vetvetishme të një auditimi, së bashku me kufizimet e që sjell testimi mbi mbi bazen e kampionit, ekziston një rrezik i pamënjanueshëm që disa nga anomalitë të mbeten të pazbuluara, edhe pse auditimi është planifikuar siç duhet dhe kryer në përputhje me standardet profesionale.

Siç e kemi prezantuar dhe në raportet e ndërmjetme, evidenca që kemi parashikuar të sigurojme me këtë proces, mbështetur dhe në udhëzimet e KQZ-së, janë marrja e informacioneve për:

- Numrit të zyrave zgjedhore për një lagje ose fshat, për të bërë kontrollin e zbatimit të rregullit që dikton subjektet zgjedhore të ngrenë jo më shumë se një zyrë elektorale për lagje qyteti ose fshat.
- Madhësi të zyrave elektorale, për të bërë përlogaritjen e kostos financiare të veprimtarive, shërbimeve apo materialeve që përdoren për qëllime zgjedhore.
- Materialeve propagandistike të përdorura, me qëllim kontrollin e llojeve të materialeve që janë objekt kufizimi dhe për qëllime të përlogaritjes së shpenzimeve.
- Vendosies të materialeve propagandistike, për të kontrolluar përdorimin dhe afishimin e materialeve propagandistike zgjedhore statike, përfshirë flamuj dhe postera në një distancë jo më të madhe se 5 metra larg zyrës elektorale të subjektit zgjedhor.
- Dokumentave të përdorimit të zyres për të gjetur burimin e financimit, kontrate qeraje apo donacion nga simpatizantët.

Për realizimin e saj, grupi i angazhimit ka përdorur procedurën e vëzhgimit dhe inspektimit i zyrave në terren dhe konfirmimet nga bashkitë, si institucione që kanë rol kontrollues për këto çështje.

C. PREZANTIMI I SUBJEKTIT ZGJEDHOR TEK AUDITUESI LIGJOR

Prezantimi i subjektit zgjedhor

Forma e organizimit dhe menaxhimit (qendra dhe degët rajonale)

Partia Emigracioni Shqiptar është regjistruar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë me urdhër nr. 66 datë 20.03.2017 të Ministrisë së Drejtësisë. Kryetar i saj është zoti Kostaq Papa i cili është i autorizuar të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme për aktivitetin normal të partisë. Qëllimi dhe objektivat e kësaj Partie gjejnë pasqyrim të qartë në Programin dhe Statutin e saj. Subjekti zgjedhor Partia Emigracioni Shqiptarë është një bashkim politik i qytetarëve shqiptarë e cila e ushtron veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Adresa e Partisë Emigracioni Shqiptarë është në Lagjen Ali Demi, pallati 157, shk 2 kati 1, Tiranë.

Aktivitetet kryesore elektorale jane të organizuara nga shtabi elektoral qendror, por në menyre të pavarur ato zhvillohen dhe nga kandidatet në zonat e tyre. Gjatë periudhës së funksionimit normal të partisë kryerja e punëve të përditëshme mbeshtetet në punën vullnetare të antarëve dhe simpatizantëve të saj, ajo ka vetëm një të punësuar të regjistruar. Sistemi kontabel eshte i organizuar ne qender dhe mbajtja e llogarive realizohet nga vullnetare. Kjo shtate ka vazhduar edhe gjatë zhvillimit te fushates dhe nuk ka shtese të punesuarish.

D. PARAQITJA E RAPORTIT DHE STRUKTURA E TIJ

Struktura e raportit të auditimit – kërkesat formale, të ardhurat dhe shpenzimet

Përmenden takimet dhe komunikimet e mundshme midis audituesit ligjor dhe subjektit zgjedhor dhe çdo person tjetër të tretë

Ne zbatim te kontrates se sherbimit, pervec informacionit te percjellur elektronikisht me perfaqesuesin e Partise Emigracioni Shqiptar Z. Kostaq Papa kam zhvilluar disa takime ne kuader te zbatimit te procedures audituese te percaktuar nga KQZ-ja.

Partia Emigracionit Shqiptar ka paqitur kandidat per kryetar bashkie ne Bashkine Kelcyre dhe lista me kandidate per anetar te keshillit bashkiak vetem ne bashkine Gramsh e ne Bashkine Kelcyre. Kjo parti nuk ka pasur zyra elektorale as ne bashkite ku ka pasur liste per anetar te keshillit bashkiak, e konfirmuar kjo nga pergjigja e Bashkise Kelcyre me nr protokolli 1318 date 11.06.2019 dhe ajo e Bashkise Gramsh me nr 3791/1 prot date 11.06.2019.

Te gjitha aktivitetet e kryera nga anetaret e partisë dhe simpatizantët e saj janë kryer në biseda familjare me të njohur dhe në raste të vecanta në lokale të ndryshme si në Tirane, Laprake, Kamez, Kelcyre e Gramsh. Në rastet kur kam mundur të kontaktoj kryetarin e partisë dhe perfaqesues të shtabeve elektorale në Gramsh e në Kelcyre kam konstatuar se nuk kishte organizime takimesh me pjesmarrje të gjere por sipmatizantët e partisë apo vullnetare të ndryshëm takonin njëzë të njohur apo miq për të kërkuar votën për partinë e Emigracionit Shqiptar. Sipas programit të fushates që Kryetari i Partisë me vuri në dispozicion parashikoheshin takime sipas shtabeve elektorale. Gjithsej ishin 2 shtabe elektorale një në bashkinë Kelcyre dhe një në bashkinë Gramsh. Gjatë fushates në raportet e ndermjetme të monitorimit kam derguar të shoqeruara edhe me foto takime të kandidatit për kryetar bashkie në Kelcyre zotit Hazbi Kasaj dhe anetareve të shtabit elektoral. Po kështu në qytetin e Gramshit ku pashe takime të kryetarit të partisë me anetare e simpatizante. Për shkak të shtrirjes në teritor të madh të fshatrave vetëm kam takuar anetar të shtabit elektoral por nuk kam vajtur në fshatra.

II. KËRKESA FORMAL

1/ Data e dorëzimit			
	a) dorëzim në formë elektronike	PO	
	b) dorëzim fizik	PO	22.11.2019
2/ Nënshkrimi			
	Nënshkrimi	Eleda Dhima	Nentor 2019
3/ Llogaria bankare e veçantë / Personi përgjegjës i financës			
			Datë 13.06.2019
	b) Dokumenti i lëvizjeve në llogarinë bankare (bank statement) që mbulon periudhën e fushatës		Periudha 13.06.2019 deri me date 09.09.2019
	c) identiteti i personit përgjegjës të financës	Kostaq Papa	

A. ANALIZA

a/ Llogaria bankare e veçantë

- A është unike llogaria bankare (vetëm për qëllimin e fushatës zgjedhore) ?

Subjekti ka hapur llogarine bankare me 13.06.2019 dhe ne statement ka te paraqitura vetem komisione.

A është hapur llogaria vetëm për fushatën zgjedhore dhe për të marrë donacionet që kalojnë shumën 100,000 Lekë?

Subjekti ka hapur llogarine bankare me 13.06.2019 dhe ne statement ka te paraqitura vetem komisione.

A ka ndonjë llogari bankare tjetër, që është përdorur për të marrë financime publike dhe për të paguar shpenzimet?

Subjekti ka nje llogari bankare ne emer te partise ne Banken Raiffeisen me IBAN AL44202110060000000001402199.

- **A është siguruar i gjithë informacioni?**
 - o Evidenca e çeljes së llogarisë bankare (data, dokumenti nga banka).
Subjekti ka hapur llogarine bankare me 13.06.2019 dhe ne statement ka te paraqitura vetem komisionet mujore. Nuk ka transaksione te pasqyruara deri me date 09.09.2019. Gjendja e llogarise eshte - 3050.7 leke.
 - o Dokumenti i lëvizjeve bankare (bank statement) që kanë të bëjnë me fushatën zgjedhore.
Subjekti ka te paraqitura si transaksione vetem komisionet bankare .

b/ Personi përgjegjës për Financën

- **Identiteti i personit përgjegjës për financën:**
 - o Kush? Personi përgjegjës për thesarin (financat) e partisë, kontabilist i licencuar, vullnetar,
Personi pergjegjes per financat eshte vet kryetari i partise zoti Kostaq Papa.

- Çështje të mospërputhjeve të mundëshme.
- **Përgjegjësi për përgatitjen dhe nënshkrimin e raportit të financimit të fushatës zgjedhore:**
- Nënshkrimi i raportit të financimit të fushatës zgjedhore.
 - Subjekti politik pretendon se meqenese nuk ka mare fonde nga KQZ nuk ka detyrime per te derguar informacion per raportin financiar te subjektit.**
- Përgatitja e të gjithë dokumenteve mbështetëse: zbulimi i problemeve të paraqitjes

a) bosh/mungon informacioni	Jo		
b) dokumentacioni (shqyrtim i shpejtë)			
Subjektin zgjedhor (financierin e subjektit) na ka komunikuar se gjate fushates zgjedhore nuk ka pasur te ardhura te çfardo natyre ,po ashtu nuk ka pasur shpenzime. Nuk na eshte vene ne dispozicion dokumentacioni financiar.	Të Ardhurat		
		Financime publike	0
		Donacione private	0
		Financim nga burimet e veta të partisë	0
		Huatë/Kreditë	0
	Shpenzimet		
		Mitingjet dhe aktivitetet e fushatës	0
		Materialet promovuese	0
		Media	0
		Sondazhe të Opinionit Publik	0
		Botime	0
		Transporti	0
	Konsulenca	0	
	Reklamime në ambiente të hapura	0	
	Administrative dhe të përgjithshme	0	

III. TË ARDHURAT

A. PËRMBLEDHJE

		Sipas raportit të financimit të fushatës zgjedhore	Sipas auditimit të kryer
1/ Financimi publik			
	Shuma e pagesës paradhënie	Nuk kemi informacion per raportin e financimit të fushatës zgjedhore te pregatitur nga subjekti politik.	0
	Data e tranfertës		
	Shuma e pagesës së marrë pas zgjedhjeve		0
	Data e transfertës		
	Shuma e financimit publik e kthyer, nëse ka		0
	Data e transfertës		
2/ Donacionet private			

	Shuma e përgjithshme e raportuar		0
	Shuma e donacioneve në para		0
	Shuma e donacioneve në natyrë		0
	Përgatitet një listë e donatorëve		Nuk ka donator
	Përfshihen të gjitha dokumentet e lëvizjeve në llogaritë bankare (bank statement)		po
	Përputhshmëria midis çdo donacioni të raportuar dhe dokumentit të lëvizjeve në llogaritë bankare (bank statement) (shuma)		Nuk ka donacione
	Përputhshmëria midis çdo donacioni të raportuar dhe dokumentit të lëvizjeve në llogaritë bankare (bank statement) (data)		Nuk ka donacione
	Përputhshmëria midis çdo donacioni të raportuar dhe dokumentit të lëvizjeve në llogaritë bankare (bank statement) (donatori)		Nuk ka donacione
	Përputhshmëria mes çdo donacioni në natyrë të raportuar dhe vlerës së tregut (donatori / data)		Nuk ka donacione
	A përputhen shifrat në total (të përgjithshme)?		Nuk ka donacione
	Respektimi i kufirit të donacionit		Nuk ka donacione
3/ Financimi nga burimet e vetë partisë			
	Shuma e përgjithshme e raportuar		0
	Shuma e përgjithshme e raportuar (Zyra Qendrore)		0
	<i>Kuotat e anëtarësisë</i>		0
	<i>Botimet</i>		0
	<i>Shtypshkronja</i>		0
	<i>Marrje me qera</i>		0
	Shuma e përgjithshme e raportuar (degët lokale)		0
	<i>Kuotat e anëtarësisë</i>		0
	<i>Botimet</i>		0

	<i>Shtypshkronja</i>		0
	<i>Marrje me qera</i>		0
	Përputhshmëria mes çdo të ardhure të raportuar dhe dokumentit të lëvizjeve në llogaritë bankare (bank statement)(shuma)		0
	Përputhshmëria mes çdo të ardhure të raportuar dhe dokumentit të lëvizjeve në llogaritë bankare (bank statement) (data)		0
4/ Huatë/Kreditë			
	Shuma e përgjithshme e raportuar		0
	Shuma / shuma e huasë / kredisë (për çdo kredi / hua)		
	Data e huasë / kredisë dhe data e shlyerjes (për çdo kredi / hua)		0
	Paraqitja e dokumenteve mbështetëse (kontratat për secilën kredi / hua)		Nuk ka
5/ Marrja/Arkëtimi i të ardhurave			

Të gjithë të ardhurat në para të marra / të mbledhura përmes llogarisë specifike.	Po / Jo	Nuk ka
---	---------	--------

ANALIZA a/

Financimi publik

- Shuma dhe data e transferimit të pagesave para zgjedhore dhe pas zgjedhore të marra nga shteti: çfarë ndodh nëse pjesa e caktuar publike që duhet ndarë pas zgjedhjeve nuk është e mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet zgjedhore → që do të thotë se raporti i financimit të fushatës zgjedhore (dhe llogaria bankare) është në defiçit (kundrejt standardeve të kontabilitetit?)

Nuk ka financim publik para dhe pas zgjedhore

- Kontrolli i minutazhit që subjekti zgjedhor ka marrë nga çdo sektor i medias që siguron kohë të lirë transmetimi.

Subjekti nuk ka pasur minutazh nga media.

- Rasti/et e abuzimit/keqpërdorimit të burimeve publike, që janë burimet e siguruar nga shteti, përveç hapësirës së lirë të reklamave dhe kohës së lirë të transmetimit (*do të trajtohen më me hollësi në pjesën e shpenzimeve*).

Nuk ka keqperdorim te burimeve publike,

b/ Financimi nga burimet jo publike

- **Donatorët e lejuar:**
 - o Kontrolli i identitetit të donatorëve dhe lejueshmëria e çdo donacioni të deklaruar; Nuk ka donator.
 - o Kontrolli i shumës së përgjithshme të donacioneve nga i njëjti donator, në veçanti nëse disa donacione janë bërë në nivel qendror dhe nga një degë e partisë; Nuk ka donacione.
- **Burimet e palejuara**
- **Kontributet në natyrë**
 - o **Vlerësimi:**
 - Dallimi mes kontributit në natyrë (dhe mundësisht) sponsorizimit dhe veprimtarisë vullnetare; **Nuk ka kontribute ne natyre.**
 - Vlerësimi (rregulli i 10% më të ulët se çmimi i tregut apo mallrave/shërbimeve që arrijnë vlerën më shumë se 50,000 Lekë). **Nuk ka perfituar mallra dhe sherbime.**
 - o **Kufizimet**
 - Kontrolli i shumës së përgjithshme nga i njëjti donator, në veçanti nëse disa donacione janë bërë në nivel qendror nga një

degë e partisë;

Nuk ka donator dhe donacione.

- Kufizimet (pragu i raportimit dhe deklarimit zbatohet si për kontributet në para ashtu edhe për ato në natyrë – *si të garantojmë respektimin e kësaj dispozite kur raportet e financimit të fushatës zgjedhore konsolidojnë llogaritë e selisë së partisë me ato të degëve?*)

Nuk ka

c/ Financimi nga burimet e vetë partisë politike

- **Klasifikimi sipas zërave i të ardhurave nga burimet e vetë partisë**
 - o Kuotat e anëtarësisë: shuma e përgjithshme dhe e detajuar sipas shumave të marra
Nuk ka kuota nga antaresia
 - o Botimet
Nuk ka botime.
 - o Shtypshkronjat
Nuk ka shtypshkronja
 - o Marrja me qera....
Nuk ka ambiente te mara me qera.
- **Klasifikimi i të ardhurave që merren nga burimet e vetë partisë për secilin zë të deklaruar sipas emrit të degës**
 - o Zyrat Qendrore
Nuk ka
 - o Degët lokale
Nuk ka
- **Përputhshmëria mes natyrës dhe shumës së të ardhurave të deklaruar dhe deklarimit bankar**

Nuk ka te ardhura te deklaruar si dhe llogaria bankare nuk ka arketime apo pagesa vec komisioneve mujore.

d/ Huatë/Kreditë

- Identiteti i huadhënësit/ve
Nuk ka huadhenes
- Shuma dhe data e huasë/ve (paraqitja e kontratës së kredisë / huasë).
Nuk ka kontrat huadhenie.
- Data e shlyerjes e përcaktuar në kontratën e kredisë / huasë/ve (*problemi i huave të fshira – në rast dyshimi, e rëndësishme që të theksohet*)
- Normat e interesit (*llogaritet tek shpenzimet si një shpenzim zgjedhor?*)

IV. SHPENZIMET

A. PËRMBLEDHJE

Shuma e përgjithshme e raportuar	Subjekti ka deklaruar se nuk ka kryer shpenzime	
Respektimi i kufirit të shpenzimit	Nuk ka shpenzime.	
Shpenzimet e kryera nga Zyra Qendrore e partisë		

	Shpenzimet zgjedhore të deklaruar në raportin e financimit të fushatës zgjedhore	Faturat e paraqitura	Faturat e Përgjithshme	Dokumente mbështetëse që mungojnë	Shpenzime të papaguara	Mospërputhje në lidhje me dokumentet e paraqitura nga furnitorët	Shuma e përgjithshme e shpenzimeve zgjedhore sipas auditimit
Mitingjet dhe aktivitetet e fushatës							0
Materialet promovuese							0
Media							0
Sondazhet e opinionit publik							0
Botimet							0
Transporti							0
Konsulenca							0
Reklamat në ambientet e jashtme							0
Administrative dhe të përgjithshme							0
Shpenzimet e bëra nga degët e partisë							
	Shpenzimet zgjedhore të deklaruar në raportin e financimit të fushatës zgjedhore	Faturat e paraqitura	Faturat e Përgjithshme	Dokumente mbështetëse që mungojnë	Shpenzime të papaguara	Mospërputhje në lidhje me dokumentet e paraqitura nga furnitorët	Shuma e përgjithshme e shpenzimeve zgjedhore sipas auditimit
Mitingjet dhe aktivitetet e fushatës							0
Materialet promovuese							0
Media							0
Sondazhet e opinionit publik							0
Botimet							0
Transporti							0
Konsulenca							0
Reklamat në ambientet e jashtme							0
Administrative dhe të përgjithshme							0
Shpenzimet zgjedhore							

Të gjitha shpenzimet zgjedhore të bëra janë paguar përmes një llogarie të veçantë

Nuk ka shpenzime zgjedhore, gjithashtu nuk ka arkitime e pagesa ne llogarine rrjedhese ne bank

B. ANALIZA

a/ Respektimi i kufirit të shpenzimeve:

Fokusohuni tek “fushatat e shumëfishta” të bëra në nivel qendror dhe degët e partisë në të gjithë vendin;

Nuk ka shpenzime zgjedhore, te bera ne nivel qendror dhe ne deget e partise ne gjithe vendin.

b/ Analiza e të gjithë shpenzimeve të deklaruarra dhe klasifikuara sipas degës së partisë dhe kategorisë, në përputhje me modelin e raportit të financimit të fushatës zgjedhore.

- **Mitingjet dhe aktivitetet e fushatës (fokusohuni tek këto);**

Nuk ka mitingje dhe aktivite te fushates.

- Pagesa për vendin;
- Shpenzimet e zbavitjes;
- Shpenzimet e pajisjeve;
- Shpenzimet për pijet;
- Shpenzimet e dekorit/vizuale;
- Shpenzimet e Transportit;
- Shpenzimet e Administratës;

- **Materialet promovuese**

Nuk ka materjale promovuese.

- **Media**

- **Sondazhet e opinionit publik**

- **Botimet**

- **Transporti**

- **Konsulenca**

- **Reklamat në ambientet e jashtme**

- **Administrative dhe të përgjithshme**

V. PËRFUNDIMI

A. SINTEZA

- Përmbledhja e gjetjeve dhe përfundimeve

Partia e Emigracionit Shqiptar nuk eshte e paisur me zyre dhe si pasoje nuk ka as paisje apo inventar ekonomik qe do ti sherbente aktivitetit politik te kesaj partie.

- Lista e parregullsive të gjetura gjatë procesit të auditimit

Nga informacionet qe morem nga bashkite ,rezulton qe subjekti nuk pati zyra zgjedhore per fushaten prandaj nuk mund te flasim per parregullsi.

B. PËRFUNDIMI

Kryetari i Partise se Emigracionit Shqiptar zoti Kostaq Papa ka deklaruar se nuk ka perfituar fonde nga Buxheti i Shtetit per fushaten e zgjedhjeve 2019 apo fonde nga donatore persona fizike apo juridike.Nuk ka kryer shpenzime pasi ka komunikuar me ata zgjedhes qe i njeh personalisht, nuk ka hapur llogari bankare

ne funksion te fushates zgjedhore per zgjedhjen e organeve te qeverisjes vendore te dates 30 qeshor 2019.

Edhe nga monitorimi i kryer gjate fushates zgjedhore qe kam raportuar prane Komisionit Qendror te Zgjedhjeve nuk kam verejtur parregullsisepse fushata nuk kishte takime me shume zgjedhes apo zyra elektorale dhe si rrjedhim nuk kishte as shpenzime te matshme per te cillat mund te kryhen analiza.

AUDITUES LIGJOR

Eleda Dhima

Lagjja "Xhevdet Nepravishata" Lushnje

Cel: 069 40 98 121

E-mail: eledadh@yahoo.it